

Autoriteti Kontraktor:

AUTORITETI PORTUAL Durrës



**STUDIM PROJEKTIM PËR OBJEKTIN:
“Pastrimi i sheshit të ish kantierit”**

Relacion Teknik

Hartoi:

UTS-01 shpk

maj, 2021

Contents

1	Informacion i Përgjithshëm	3
1.1	Projekti	3
1.2	Përfituesi	3
1.3	Zhvilluesi	3
1.4	Autoriteti Kontraktor	3
1.5	Projektues	3
1.6	Vështrim i përgjithshëm i Portit Durrës	3
1.6.1	Përshkrim i gjendjes ekzistuese të sheshit	4
1.6.2	Foto të gjendjes ekzistuese të sheshit	4
2	Qëllimi	5
2.1	Qëllimi i përgjithshëm	5
2.2	Informacioni grumbulluar	5
2.3	Përftimet nga realizimi i projektit	7
3	Karakteret e ndërhyrjeve të parashikuara	7

1 Informacion i Përgjithshëm

1.1 Projekti

Ky projekt hartohet në zbatim të kontratës “Hartim Projekti “Hedhje rrafshim ngjeshje çakëll, stabilizant zona ish-kantierit dhe ish peshkimit dhe prishja e godinës së ish kantierit””. Ky shërbim konsiston në projekte më vete për:

- **Pastrimi i ish kantierit**
- Prishja e godinës së ish kantierit
- Rehabilitimi i ish peshkimit

1.2 Përfituesi

Autoriteti Portual Durrës

1.3 Zhvilluesi

Autoriteti Portual Durrës

1.4 Autoriteti Kontraktor

Autoriteti Portual Durrës

1.5 Projektues

UTS-01 Sh.p.k.

1.6 Vështrim i përgjithshëm i Portit Durrës

Porti i Durrësit ndodhet në pjesën jug-perëndimore të Qytetit në skajin verior të Gjirit të Durrësit. Pozicioni i tij gjeografik e bën Portin e Durrësit portin më të madh në Shqipëri dhe një nga më të mëdhenjtë ndër portet e Detit Adriatik e Jon.

Infrastruktura operacionale e portit konsiston me një thellësi prej 7.5m deri 11.5m. Mallrat që përpunohen në këto kalata janë kontenierë edhe ngarkesa rifuxhio. Porti gjithashtu përpunon një numër të madh pasagjerësh.

Porti i Durrësit është i organizuar nga ana operacionale në 4 terminale:

- Terminali Lindor
- Terminali i Trageteve
- Terminali i Konteniereve
- Terminali Perëndimor




Fig. 1 Pozicioni i zhvillimit mbi rilevimin topografik (G.I.S)

Në zonën e sipërpërmendur parashikohen ndërhyrje rehabilituese të cilat tjetërsojnë imazhin e zonës dhe të portit në tërësi. Aktualisht në territorin e ish kantierit prej vitesh nuk ka mirëmbajtje të sheshit dhe në shesh gjithashtu ka rrënoja ndërtesash, pjesë me bimësi, dhe mbeturina dhe për pasojë pjesa më e madhe e sheshit nuk është e shfrytëzueshme. Sipërfaqja totale e sheshit është 67300 m² dhe pastrimi i kësaj sipërfaqeje, mundësisht deri në zbulimin e shtresave ekzistuese të betonit e bën këtë sipërfaqe territori të portit të jetë e përshtatshme për tu përdorur si shesh, parkim apo sipas qëllimeve të APD.

1.7 Përshkrim i gjendjes ekzistuese të sheshit

Aktualisht në territorin e ish kantierit prej vitesh nuk ka mirëmbajtje të sheshit dhe në shesh gjithashtu ka rrënoja ndërtesash, pjesë me bimësi, dhe mbeturina dhe për pasojë pjesa më e madhe e sheshit nuk është e shfrytëzueshme. Kjo sipërfaqe territori aktualisht është e mbushur me rrënoja dhe me papastërti të ndryshme. Krahas imazhit të keq vizual kjo zonë në gjendjen e tanishme është e pashfrytëzueshme dhe në të vazhdojnë hidhen mbeturina dhe në disa pjesë sheshi i ngjan një venddepozitime. Pjesa më e madhe e sheshit aktualisht është e pashfrytëzueshme edhe pse poshtë shtresave të dheut, bimësisë apo mbeturina sheshi ka shtresë betoni të sheshtë dhe të përshtatshme për shfrytëzim.

1.8 Foto të gjendjes ekzistuese të sheshit





Fig. 2 Foto të zonës ku zhvillohet projekti

2 Qëllimi

2.1 Qëllimi i përgjithshëm

Të hartohet një projekt zbatimi i plotë, i cili i përgjigjet satndarteve të ndërtimit në fuqi.

Dokumentacioni i përgatitur të jetë i gatshëm për tu përdorur për aplikim për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi në sistemin e-leje.

Dokumentacioni i përgatitur të jetë ii gatshëm për tu përdorur për procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në të ardhmen me qëllim përzgjedhjen e kompanisë që do të zbatojë punimet e ndërtimit.

2.2 Informacioni grumbulluar

Për qëllimin e hartimit të projektit iu kërkua azhurnimi i rrjeteve inxhinierike të fshehura në zonë nga APD i cili u shpreh se krahas faktit se nuk ka materialet mbi rrjetet inxhinierike në zonë gjithashtu në zonë krahas linjës për funrizim me energji elektrike të ndërtesave të shfrytëzueshme në shesh dhe linjës nëntokësore të largimit të ujit nga po këto ndërtesa nuk ka linja të tjera ajrore (dhe nga informacioni i grumbulluar as nëntokësore). Megjithatë vlen të përmendet se infrastruktura nëntokësore nuk preket nga ndërhyrjet e prashikuara.

Në kuadër të hartimit të projektit është bërë rilevimi me dron dhe janë përdorur programe dhe aparatura të posaçme për përcaktimin e relievit (kuotave).



Fig. 3 Terreni i rilevuar me dron

Nga informacioni i grumbulluar për sheshin rezulton se sheshi në të ardhmen parashikohet për vendparkim të mjeteve të rënda të cilat aktualisht bllokojnë trafikun në rrugët e portit ndërkohë që mbajnë radhë për të kaluar në skanim.




Fig. 4 Parashikimi për përdorimin e zonës nga APD

2.3 Përfitimet nga realizimi i projektit

Përfitimi i këtij projekti është se kthen të gjithë sheshin e ish kantierit nga një shesh rrënojash e mbeturinash dhe fare pak të përdorshëm në një shesh të përshtatshëm për parkim apo për qëllime të tjera sipas nevojave të APD-së. Gjithashtu pastrimi i këtij sheshi dhe kthimi i tij në një shesh funksional rrit ndjeshëm edhe imazhin e portit. Duke qenë se mjetet e rënda me ngarkesë nuk kanë parkim të mjaftueshëm për mbajtjen e radhës për skanim dhe sheshi ndodhet ngjitur me sheshin e skanerit atëherë kthimi i kësaj sipërfaqeje në sipërfaqe të shfrytëzyeshme i shërben ndër të tjera edhe logjistikës Portuale.

3 Karakteri i ndërhyrjeve të parashikuara

Në shesh nuk parashikohen punime ndërtimi. Ndërhyrjet e parashikuara janë pastrim e gërmime me qëllim largimin e mbeturinave dhe nuk parashikohen punime të mirëfillta ndërtimi.